



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS

STATUTI

Maj 2014

1. Bazuar në nenin 17, nenin 19, nenin 20, nenin 21, nenin 45 paragrafi 3, dhe nenin 63 të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, nenin 2 dhe 12 paragrafi 2.11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (në vazhdim të tekstit, SHSKUK),; në propozim të Bordit Drejtues të SHSKUK Ministria e Shëndetësisë e miraton Statutin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (në vazhdim të tekstit QKUK).

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1. Me këtë Statut përcaktohet emërtimi, selia, udhëheqja, organizimi, veprimtaria, trupat, aktet e përgjithshme, pronësia, financimi, transparenca, fshehtësia afariste dhe profesionale, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, dhe mbikëqyrja e brendshme, përkritazi me ushtrimin e veprimtarisë së njësive përbërëse organizative të QKUK si dhe QKUK si tërësi.
2. QKUK ka filluar punën në Dhjetor të vitit 1958 si Spitali i Prishtinës dhe ushtroi veprimtarinë si i këtillë deri me 7 Nëntor 1973 kur u bashkua me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (në vazhdim të tekstit, FM i UP) si Organizatë e Punës së Bashkuar; kurse prej 29 Dhjetorit 1977 deri me 1991 zhvilloi veprimtarinë si organizatë punuese e FM të UP me Klinikat përbërëse. Nga Qershori i vitit 1999 ka zhvilluar veprimtarinë si QKUK.

Neni 2

1. QKUK dhe njësitë e saj përbërëse organizative janë njësi përbërëse organizative dhe funksionale të SHSKUK.
2. Njësitë përbërëse organizative të QKUK kanë statusin e personit juridik, me cilësi të autoritetit punëdhënës.
3. Organizimi dhe funksionimi i njësive përbërëse organizative të QKUK përcaktohet me Statutin e tyre.
4. Statuti i njësive përbërëse organizative të QKUK miratohet nga Ministri i Shëndetësisë në propozim të Bordit Drejtues të SHSKUK.
5. Njësitë përbërëse organizative të QKUK në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës Nr. 04/L -125, në bashkëpunim kontraktuar me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit "Hasan Prishtina" (FM – UP), organizojnë, ofrojnë dhe zbatojnë procesin mësimor universitar, punën kërkimore shkencore, zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe shkollimin specialistik dhe sub-specialistik të profesionistëve shëndetësorë.
6. Njësitë përbërëse organizative të QKUK zbatojnë kujdesin shëndetësor tretësor në nivel të vendit si dhe kujdesin shëndetësor dytësor për komunën e Prishtinës dhe komunat e afërta.

Neni 3

1. Njësitë përbërëse organizative të QKUK disponojnë me mjetet dhe pasurinë e cila është pronë e SHSKUK.
2. Njësitë përbërëse organizative të QKUK si institucione shëndetësore publike janë përvetësuese të fondeve nga Buxheti i Kosovës si dhe burimeve të tjera financiare të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Emërtimi dhe selia

Neni 4

1. Emri i institucionit të veçantë (njësisë përbërëse organizative të QKUK) është Klinika e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).
2. Emri përfaqësues i të gjitha njësive përbërëse organizative të QKUK është Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
3. Shenja njohëse e QKUK është shqiponja dykrahëshe, në këmbët e saj me gjarprin e mbështjellë si shenjë mbrojtëse në mes të vulës.
4. Emërtimi i njësive përbërëse organizative të QKUK mbishkruhet në gjuhët në përdorim zyrtar.
5. Ndryshimi i emrit dhe selisë së njësive përbërëse organizative të QKUK bëhet me propozim të njësive dhe me aprovimin e SHSKUK.
6. Selia e QKUK dhe njësive të saja përbërëse organizative gjendet në adresën: "Rrethi i Spitalit" p.n., Prishtinë.

Statusi dhe prezantimi

Neni 5

1. Njësitë përbërëse organizative të QKUK janë institucione shëndetësore të cilat evidentohen në regjistrin e njësive përbërëse organizative të SHSKUK.
2. Njësitë përbërëse organizative të QKUK janë njësi autonome të cilat organizojnë dhe drejtojnë punët e tyre të rregullta administrative dhe profesionale në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë ligjore, përveç detyrave dhe përgjegjësisë të cilat sipas Ligjit për shëndetësi dhe Statutit të SHSKUK-së i janë caktuar SHSKUK-së.
3. Njësitë përbërëse organizative të QKUK ofrojnë shërbime shëndetësore sipas parimeve të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësi si dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi.
4. Çfarëdo fitimi, tjetërsimi, apo shitje e patundshmërive të njësive përbërëse organizative të QKUK u nënshtrohet akteve ligjore në fuqi.
5. Për çfarëdo fitimi, tjetërsimi, apo shitje të patundshmërive të njësive përbërëse organizative të QKUK nevojitet miratimi i Bordit Drejtues të SHSKUK.
6. Në rast të nënshkrimit të kontratave nga paragrafi 3 i këtij neni, njësitë përbërëse organizative të QKUK paraqiten si subjekte të pavarura juridike dhe afariste.
7. Qarkullimi i mjeteve financiare të njësive përbërëse organizative të QKUK bëhet përmes kodit organizativ të SHSKUK si dhe nën kodeve të njësive të tij përbërëse nga neni 12.2 i këtij Statuti, të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të aprovuara nga Ministria e Financave
8. Drejtorët e njësive përbërëse organizative të QKUK dhe Drejtori i përgjithshëm i SHSKUK kanë të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist të njësive përbërëse organizative të QKUK.